

AKT NORMATIV
Nr. 12, datë 25.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 112/2020, “PËR
REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 2, fjalët “... komunitetet fetare ...” zëvendësohen me fjalët “... bashkësitë fetare ...”.

Neni 2

Në pikën 3.2.1, të nenit 4, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalët “... adresa e rezidencës së përhershme ...” zëvendësohen me “... adresa e vendbanimit ...”.

2. Në shkronjën “c”, pas paragrafit “data e lëshimit dhe data e skadimit e dokumentit të udhëtimit” shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“- adresa e vendbanimit.”.

Neni 3

Në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 5, fjalët “... brenda 30 ditëve ...” zëvendësohen me “... brenda 90 ditëve ...”.

Neni 4

Në pikën 1, të nenit 14, fjalët “... në pikën 5.1 ...” zëvendësohen me “... në pikën 3.1...”.

Neni 5

Në nenin 15, fjalët “... jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga krijimi i regjistrit, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij neni ...” zëvendësohen me “... brenda datës 30.6.2021 ...”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe